

Alban Beqaj

Z. Alban Beqaj që prej muajit shkurt 2025 mban detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Regjistrave dhe Analizës në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Para se të merrte këtë detyrë, ka shërbyer si Drejtor i Politikave të Zhvillimit të Pronës Shtetërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ka qenë gjithashtu për një periudhë të gjatë përgjegjës i Degës së Shoqërive Publike për Qarkun e Tiranës, ndërkohë që ka ushtruar edhe detyra të tjera të rëndësishme si anëtar dhe kryetar i Këshillave Mbikëqyrës të disa shoqërive shtetërore, përfshirë “Instituti të Sigurimeve Shoqërore”, “Autoritetit Portual Durrës”, “KESH” sh.a., “Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., etj.

Gjithashtu, ka mbajtur funksione të rëndësishme pranë Këshillit të Ministrave si: Anëtar i Bordit të Monitorimit të Planit Antikorrupsion, Përgjegjës i sektorëve të informacionit, publikimit dhe aksesit në publik në Departamentin e Informacionit.

Në periudha të tjera të ndryshme ka ushtruar detyrën e Këshilltarit të Ministrit të Financave, si edhe Këshilltar i Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Fillimet e veta i ka në fushën e medias ku është vlerësuar edhe me çmime të veçanta për veprimtarinë e ushtruar në të gjithë pozicionet që nga gazetar i thjeshtë deri në drejtues në disa prej gazetave dhe revistave më të njohura të kohës në Shqipëri.

Z. Beqaj është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, dega Ekonomiks, dhe zotëron dy diploma Master: Për Marëdhënie Ndërkombëtare e Europiane më Institute de Recherches et d'Etudes en Relations Internationales e Europeennes, Francë dhe një tjetër profesional në Bussiness Law nga Tirana Business University. Ka ndjekur një sërë programesh trajnimi brenda dhe jashtë vendit. Zotëron gjuhët e huaja anglisht dhe italisht.